



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. **147**

Prishtinë, më 6.5.2014, ora 11,50

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Faton Topalli, Rasim Demiri, Sevdije Lama, Afërdita Berisha-Shaqiri, Salih Morina, Ramiz Lladrovci, Nijazi Idrizi.
Mungoi : Boban Todorović.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: sipas listës së nënshkruar nga pjesëmarrësit.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës ;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 29.4.2014,
3. Gjendja e projektligjeve në komision,
4. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndonjë ndryshim.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 29.4.2014

Kryetari i Komisionit konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 29 prill 2014.

3. Gjendja e projektligjeve në komision

Kryetari Nait Hasani fillimisht arsyetoi mbajtjen e kësaj mbledhjeje urgjente duke sqaruar se është dashur që deri sot të kryhet projektligji për zhurmën në komisionet e përhershme, mirëpo pasi që nuk është përfunduar në komisionin për legjislacion, ai shfrytëzoi rastin të falënderoi anëtarët prezent të komisionit për angazhimin e treguar në këtë legjislacion rreth rezultateve të treguara, meqë mund të ndodhë që kjo mbledhje mund të jetë e fundit në këtë legjislacion.

Mbledhja përfundoi në orën 12,10.

Përgatitur nga :

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,
Nait Hasani